



Co-funded by  
the European Union

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
  
Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

Sweden  
Sverige



Norwegian Embassy

Platforma Civikos me mbështetje të DEMOS kanë formuar grupin e Auditimit Social në Janjevë.

Projekti	<b>Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit në Janjevë</b>
Çmimi total i punëve në kontratë	<b>EUR 32,930.94</b>
Statusi i kontratës	<b>I përfunduar</b>

Grupi i Auditimit Social në Janjevë ka 16 anëtarë, përfaqësues të komunitetit Rom dhe Kroat që jetojnë në Janjevë.



## GJETJET KRYESORE



Investimi ka ardhur si kërkesë e qytetarëve të Janjevës nga dëgjimet buxhetore të organizuara nga Komuna e Lipjanit në vitin 2018.



Projekti i realizuar nuk e përmirëson problemin e furnizimit me ujë për qytetarët e Janjevës.



Në Janjevë ka mungesë të theksuar të ujit të pijshëm sidomos tek lagjia e Romëve.



Komuna e Lipjanit nuk ka organizuar konsultim të veçantë me banorët e Janjevës gjatë procesit të planifikimit të projektit.



Rrjeti i ujësjellësit në Janjevë është i vjetërsuar, ka rrjedhje të pa kontrolluara në shtëpi të pa banuara.



Banorët e Janjevës kanë mungesë të informacioneve për investimet e nevojshme për adresimin e problemit të furnizimit me ujë të pijshëm në Janjevë.

## REKOMANDIMET

Komuna e Lipjanit të përfshijë banorët e Janjevës në vendimmarrje sa i përket investimeve në rrjet të ujësjellësit.

Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina dhe Komuna e Lipjanit të punojnë se bashku për të gjetur zgjidhje në furnizim të Janjevës me ujë të pijshëm, si dhe mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit në Janjevë.